



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës**      **KSC-BC-2020-06**

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe  
Jakup Krasniqit**

**Vendosi:**              **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:**    **Dr. Fidelma Donlon**

**Data:**                **23 nëntor 2020**

**Gjuha:**              **Anglishte**

**Klasifikimi:**        **Publik**

---

**Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me të**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Dejvid Hupër

**Zyrës Administrative**

Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe  
Mbështetjen e Dëshmitarëve

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 95(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Midis 9 dhe 11 nëntorit 2020, u mbajtën paraqitjet e para në përputhje me rregullën 92 të Rregullores për z. Krasniqi,<sup>2</sup> z. Thaçi,<sup>3</sup> z. Veseli,<sup>4</sup> dhe z. Selimi.<sup>5</sup> Gjatë paraqitjeve të para, të gjithë të akuzuarit deklaruan se e kuptonin dhe e flisnin gjuhën shqipe.<sup>6</sup>

2. Më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin për gjuhën e punës” (“Vendim për gjuhën e punës”), ku përcaktoi se anglishtja do të jetë gjuhë pune e procesit aktual, për të cilën palët ishin pajtuar.<sup>7</sup>

3. Gjithashtu më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Urdhrin e caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve”, ku caktoi konferencë mbi ecurinë e çështjes në praninë e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe Mbrojtjes për të mërkurën, 18 nëntor 2020.<sup>8</sup> Ai gjithashtu kërkoi nga ZPS-ja dhe Mbrojtja që, përkatësisht deri të premten, 13 nëntor

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 21 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Krasniqi), 9 nëntor 2020.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Thaçi), 9 nëntor 2020.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Veseli), 10 nëntor 2020.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Selimi), 11 nëntor 2020.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Krasniqi), 9 nëntor 2020, f. 5, rreshtat 2-3; Transkript i seancës (z. Thaçi), 9 nëntor 2020, f. 29, rreshtat 14-16; Transkript i seancës (z. Veseli), 10 nëntor 2020, f. 59, rreshtat 18-22; Transkript i seancës (z. Selimi), 11 nëntor 2020, f. 79, rreshtat 21-22.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00072, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për gjuhën e punës*, 11 nëntor 2020, publik, paragrafët 7, 26(a).

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër i caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve* (“Urdhër i caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes”), 11 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, publik, para. 21(a).

2020, dhe deri të martën, 17 nëntor 2020, të dorëzonin parashtrime me shkrim për cilëndo pikë të rendit të ditës të konferencës mbi ecurinë e çështjes, sistemin e redaktimit që duhet të zbatohet në procesin aktual, dhe/ose për tema të tjera relevante.<sup>9</sup> Parashtrime të tilla u paraqitën nga ZPS-ja<sup>10</sup> dhe Mbrojtja për z. Krasniqi,<sup>11</sup> z. Selimi,<sup>12</sup> z. Thaçi,<sup>13</sup> dhe z. Veseli.<sup>14</sup>

4. Më 18 nëntor 2020, u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores (“konferencë mbi ecurinë e çështjes”).<sup>15</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në përputhje me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të ZPS-së që janë në favor apo kundër të akuzuarit i vihen atij në dispozicion para fillimit të procesit dhe gjatë procedurave, objekt vetëm i kufizimeve që janë rreptësisht të domosdoshme dhe kur zbatohen masa të domosdoshme mbrojtëse balancuese.

6. Në përputhje me rregullën 46(1) të Rregullores, dhe varësisht prej detyrimeve të Administratorit përcaktuar në rregullën 24, ZPS-ja është përgjegjëse për mbajtjen,

<sup>9</sup> Urdhër i caktimit të datës për konferencën mbi ecurinë e çështjes, para. 21(b)-(c).

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00076, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes* (“Parashtrimet me shkrim të ZPS-së”), 13 nëntor 2020, publik.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00082, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Parashtrime të Mbrojtjes për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes në emër të Jakup Krasniqit* (“Parashtrimet me shkrim të Krasniqit”), 17 nëntor 2020, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00083, Mbrojtja e z. Selimi, *Parashtrimet e Mbrojtjes për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes* (“Parashtrimet me shkrim të Selimi t’”), 17 nëntor 2020, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00085, Mbrojtja e z. Thaçi, *Parashtrimet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes* (“Parashtrimet me shkrim për Thaçin”), 17 nëntor 2020, publik.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-06, F00087, Mbrojtja e z. Veseli, *Parashtrimet në emër të Kadri Veselit për konferencë mbi ecurinë e çështjes, e mërkurë 18 nëntor* (“Parashtrimet me shkrim të Veselit”), 17 nëntor 2020, publik.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-06, Version i parë i transkriptit të seancës, 18 nëntor 2020 (“Transkripti i datës 18 nëntor 2020”), publik.

ruajtjen dhe sigurinë e informacionit dhe materialit fizik dhe elektronik të mbledhur gjatë hetimeve të veta.

7. Në përputhje me rregullën 95(2)(b) të Rregullores, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit sipas rregullës 92 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afatet për nxjerrjen e provave, merr masa për të mundësua nxjerrje të provave në kohë, dhe përgatit një raport për trupin gjykues, mbi nxjerrjen e provave.

8. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; dhe (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

9. Në përputhje me rregullën 102(1)(a) të Rregullores, dhe në varësi të dispozitave të rregullës 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, materialet mbështetëse të aktakuzës së konfirmuar, si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda tridhjetë (30) ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit.

10. Në përputhje me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afateve të caktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes këto materiale: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që ZPS-ja e ka ndërmend t'i ftojë të dëshmojnë në gjykim, në gjuhën të cilën i Akuzuari e kupton dhe e flet. (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet ose transkriptet që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim. dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

11. Në përputhje me rregullën 102(2) dhe (4) të Rregullores, deklarata të dëshmitarëve shtesë të ZPS-së, të cilat nuk janë nxjerrë brenda afatit prej 30 ditësh para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë që të dëshmojnë në gjykim, i vihen në dispozicion Mbrojtjes sa më parë që është e mundshme, në gjuhë që i akuzuari e kupton dhe e flet, së bashku me arsyen për nxjerrjen e vonuar të materialit. Nxjerrja e materialeve të tilla përfundohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

12. Në përputhje me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja vë në dispozicion të Mbrojtjes çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e ZPS-së, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit.

13. Në përputhje me rregullën 103 të Rregullores, dhe që është objekt i rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion, sapo të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të saj, për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së.

14. Në përputhje me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullat 80(1) dhe 108(1)(b) të Rregullores, një panel mund të urdhërojë, *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë, masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve.

15. Në përputhje me rregullën 80(4)(a)(i)-(iii), (d), dhe (e) të Rregullores, ndër masa të tilla mund të përfshihen fshirja e emrave dhe të dhënave identifikuese për të parandaluar nëse është e domosdoshme, nxjerrjen për të akuzuarit dhe/ose publikun,

të identitetit ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces gjyqësor, ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër me ta.

16. Në përputhje me rregullën 107(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën panelit kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për t'u liruar, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimi sipas rregullës 102 dhe rregullës 103 për nxjerrjen e materialit fillestar nëse informacioni, të cilin e ka nën ruajtje ose kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja dhe për të cilin nuk e ka pëlqimin e burimit të informacionit për ta nxjerrë.

17. Në përputhje me rregullën 108(1)(a) dhe (c) të Rregullores, ZPS-ja mund të kërkojë nga paneli që të mos nxjerrë informacionin, tërësisht ose pjesërisht, kur nxjerrja e këtij informacioni mund të cenojë hetimet aktuale, ose hetimet e ardhshme ose të jetë në kundërshtim, për ndonjë arsye tjetër, me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta. Në përputhje me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

18. Në përputhje me rregullën 109(b) dhe (c) të Rregullores, edhe ZPS-ja edhe Mbrojtja, nëse kjo e fundit vendos të nxjerrë ndonjë informacion, kur nxjerrin informacion, paraqesin: (i) një përshkrim të qartë dhe të përmbledhur të dokumenteve, ose kategorive të dokumenteve, që i janë dhënë palës kundërshtare; (ii) një kategorizim të informacionit të nxjerrë në përputhje me akuzat e Aktakuzës së Konfirmuar, me referenca konkrete për veprat penale bazë, elementet kontekstuale të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provat që do të paraqiten nga ZPS-ja.

19. Në përputhje me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron ZPS-në që brenda një afati të caktuar të paraqesë dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon të thërrasë të dëshmojnë në gjykim

dhe listën e provave materiale të propozuara që Prokurori i Specializuar synon të paraqesë në gjykim.

20. Në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores, pas paraqitjes së dosjes paraprake dhe listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të propozuara nga ZPS-ja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjet përkatëse paraprake që përmbajnë: (i) një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së mbrojtjes së të akuzuarit; (ii) akuzat dhe pikat që i akuzuari kundërshton, duke iu referuar paragrafëve konkretë në dosjen paraprake të ZPS-së dhe arsyet e kundërshtimit të tyre nga i akuzuari; (iii) listën e dëshmitarëve të mundshëm që ata synojnë t'i thërrasin, si edhe me cilin aspekt përkatës konkret kanë të bëjnë, e cila nuk paragjykon ndryshime të mëvonshme të listës ose paraqitjen e këtyre ndryshimeve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu kërkon nga Mbrojtja, që brenda një afati të përcaktuar, ta njoftojë ZPS-në dhe trupin gjykues mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale.

21. Në përputhje me rregullën 104(5) të Rregullores, brenda afatit të caktuar nga paneli dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara hapjes së çështjes, Mbrojtja: (i) e lejon ZPS-në që të këqyrë dhe të bëjë kopje të çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Mbrojtjes, të cilat Mbrojtja synon t'i përdorë si prova në gjykim; (ii) i jep ZPS-së të gjitha deklaratat, nëse ka, të të gjithë dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim ose synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) i jep ZPS-së të gjitha provat materiale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim.

22. Në përputhje me rregullat 106, 107(1) dhe 111(1) të Rregullores, kategori të caktuara të materialit janë, në parim, të përjashtuara nga nxjerrja e informacionit, në varësi të Rregullores dhe përveçse kur paneli urdhëron ndryshe. Këto përfshijnë: (i) raportet, memorandumet, ose dokumentet e tjera të brendshme të përgatitura nga



ZPS-ja (përfshirë Task Forcën Hetimore Speciale), Mbrojtja dhe mbrojtësit e viktimave, përfshirë ndihmësit dhe përfaqësuesit e tyre (rregulla 106 e Rregullores); (ii) materialin që i është dhënë ZPS-së në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja (rregulla 107(1) e Rregullores); dhe (iii) komunikimet e privileguara përkufizuar në rregullën 111(1) të Rregullores.

### III. PARASHTRIMET E PALËVE

#### 1. ZPS-ja

23. Sa i përket zhvillimit të hetimeve, ZPS-ja parashtron se një numër i veprimeve hetuese në çështjen aktuale janë të papërfunduara, disa nga të cilat mund të kryhen vetëm pas publikimit të çështjes.<sup>16</sup> Ndërsa ka gjasa që do të dalin prova të reja si rezultat i këtyre hetimeve, ZPS-ja aktualisht nuk parashikon pasoja për zhvillimin e shpejtë të procesit gjyqësor, dhe është duke punuar për t'i përfunduar këto veprime hetimore gjatë fazës paraprake të procedurave.<sup>17</sup>

24. Sa i përket nxjerrjes së provave, ZPS-ja parashtron se kërkon afat të plotë prej 30 ditës siç është përcaktuar në rregullën 102(1)(a) të Rregullores për nxjerrjen e materialit mbështetës të Aktakuzës së Konfirmuar, përfshirë dhe përmbledhjen e detajuar bashkëngjitur materialit mbështetës të aktakuzës, e përgatitur në përputhje me rregullën 86(3)(b) të Rregullores (“përmbledhja e detajuar”), duke pasur parasysh vëllimin e këtij materiali, nevojën për redaktime të gjera, dhe kriteret e përkthimit.<sup>18</sup> Në lidhje me këtë material, ZPS-ja tashmë ka bërë kërkesë për masa mbrojtëse.<sup>19</sup>

---

<sup>16</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 3.

<sup>17</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 3.

<sup>18</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 7-9.

<sup>19</sup> KSC-BC-2020-06, F00094, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për masa mbrojtëse*, 19 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-13, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.



25. Sa i përket materialit sipas rregullës 102(1)(b), ZPS-ja beson se do të jetë në gjendje ta nxjerrë këtë deri më 31 maj 2021, ose, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes prej ZPS-së.<sup>20</sup> ZPS-ja parasheh që ky material do të përfshijë përafërsisht edhe 50 dëshmitarë të tjerë dhe afërsisht 1500 prova materiale.<sup>21</sup> Sa i përket këtij materiali, ZPS-ja parasheh që të jetë në gjendje që të paraqesë kërkesën e dytë për masa mbrojtëse në shkurt 2021.<sup>22</sup>

26. Për materialin sipas rregullës 102(3), ZPS-ja beson se do të jetë në gjendje t'i japë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm për provat që mund të jenë thelbësore për përgatitjen e tyre deri më 30 prill 2021.<sup>23</sup> Provat që do të përfshihen në njoftimin sipas rregullës 102(3) do të përmbajnë çdo provë të mbetur që mund të jetë thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, pas nxjerrjes së provave sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores dhe provave që mund të jenë shfajësuese sipas rregullës 103 të Rregullores.<sup>24</sup> Duke u bazuar në analizën që është duke bërë, ZPS-ja parashtron se do jenë afër 100000 materiale sipas rregullës 102(3), dhe se një përqindje e konsiderueshme e tyre kërkon redaktime.<sup>25</sup>

27. Në lidhje me materialin sipas rregullës 103, ZPS-ja parashtron se do të nxjerrë mbi 1000 prova që mund të jenë shfajësuese jo më vonë se materialin mbështetës sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores dhe do të vazhdojë të rishikojë dhe nxjerrë materiale të ngjashme progresivisht, me redaktime nëse ka nevojë.<sup>26</sup> Në këtë aspekt, sidoqoftë, ZPS-ja kërkon që të lirohet nga detyrimi për të nxjerrë materialin e rregullës 103 të

---

<sup>20</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 2, 10.

<sup>21</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para 5, 11-12.

<sup>22</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 13.

<sup>23</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 15.

<sup>24</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 15.

<sup>25</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 16.

<sup>26</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 17.

Rregullores kur ai material është i njohur për Mbrojtjen dhe mund të sigurohet përmes ushtrimit të zellit të duhur.<sup>27</sup>

28. Sa i përket materialit të rregullës 107, ZPS-ja parashtron se është duke kërkuar leje në mënyrë aktive për të gjithë materialin e mbrojtur në çështjen aktuale.<sup>28</sup> Ajo nuk parasheh, në këtë fazë, që marrja e këtyre lejeve do të rrezikojë afatet e propozuara për nxjerrje të informacionit.<sup>29</sup>

29. Në lidhje me përkthimin, ZPS-ja parashtron se përkthimet në shqipe të deklaratave të dëshmitarëve në të cilat ZPS-ja synon të mbështetet në gjykim është përgjegjësi e ZPS-së, kurse përkthimi i dokumenteve dhe provave të tjera është kryesisht çështje midis Mbrojtjes dhe Zyrës Administrative.<sup>30</sup>

30. Sa i përket procedurës për nxjerrjen e provave, ZPS-ja parashtron se, me qëllim që plotësimi të kriterëve për kategorizim sipas rregullës 109(c) të Rregullores, një tabelë të nxjerrjes së informacionit të ngjashme me atë që është miratuar në çështjen *Prokurori k. Salih Mustafës* ("çështja *Mustafa*"),<sup>31</sup> duhet të përdoret në çështjen aktuale.<sup>32</sup> ZPS-ja gjithashtu propozon që kjo tabelë të bëhet pas paraqitjes së dosjeve paraprake përkatëse të palëve, në përputhje me rregullën 95(4) dhe (5) të Rregullores.<sup>33</sup>

31. Sa i përket sistemit të redaktimit, ZPS-ja parashtron se do të zbatohet sistemi i redaktimit i zbatuar në çështjen *Mustafa*,<sup>34</sup> në përputhje me të cilin palët mund të redaktojnë informacionin në material që është pjesë e detyrimeve të tyre për nxjerrje

---

<sup>27</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 18.

<sup>28</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 19.

<sup>29</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 20.

<sup>30</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 21-22.

<sup>31</sup> KSC-BC-2020-05, F00046, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishikim ose leje për apelim*, 5 nëntor 2020, publik, para. 16.

<sup>32</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 23.

<sup>33</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 23.

<sup>34</sup> KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje të lidhura me të* ("Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*"), 9 tetor 2020, publik, paragrafët 77-89.

të informacionit sipas Ligjit dhe Rregullores, në përputhje me disa kategori të miratuara paraprakisht.<sup>35</sup> Sa i përket procedurës për autorizimin e redaktimeve jostandarde, ZPS-ja parashtron se, për t'iu shmangur nxjerrjes të panevojshme të të njëjtit material disa herë, nuk duhet t'i kërkohet palës që nxjerr informacionin që të nxjerrë materiale që përmbajnë redaktime jostandarde në të njëjtën kohë kur paraqitet kërkesë për autorizim për zbatimin e këtyre redaktimeve, në vend të kësaj, duhet të lejohet që të presë vendimin përkatës, përveç nëse kjo do rrezikonte afatin përkatës për nxjerrjen e informacionit.<sup>36</sup>

## 2. Mbrojtja e z. Thaçi

32. Në lidhje me nxjerrjen e provave, Mbrojtja e z. Thaçi e kundërshton dhënien Gjykatësit të Procedurës Paraprake të të gjitha provave të shkëmbyera midis palëve, pa marrë parasysh nëse ato do të përdoren ose nuk do të përdoren në gjykim, në lidhje me të cilën deklaroi se, nuk parashihet në Ligj dhe Rregullore.<sup>37</sup> Ajo parashtron se një nxjerrje e tillë e përgjithshme e informacionit do të ishte paragjyquese ndaj Mbrojtjes meqenëse çdo material që i jepet Gjykatësit të Procedurës Paraprake në fund i transferohet trupit gjykues që do të emërohet, i cili do të formonte opinionin në bazë të provave të shkëmbyera midis palëve, por që nuk janë paraqiten në gjykim.<sup>38</sup>

33. Sa i përket procedurës për nxjerrjen e provave, Mbrojtja e z. Thaçi parashtron se, në kohën kur bëhet nxjerrja e informacionit, pala që bën nxjerrjen e informacionit bën të ditur, për aq sa është e realizueshme dhe përmes meta të dhënave që janë në dispozicion në *Legal WorkFlow*, nëse çdo provë e nxjerrë ka të bëjë kryesisht me ndonjë nga kategoritë e përmendura në rregullën 109(c) të Rregullores, që do të bëjë të

<sup>35</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 24.

<sup>36</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, poshtëshënimi 26.

<sup>37</sup> Parashtrimet me shkrim të Thaçit, para. 12-13.

<sup>38</sup> Parashtrimet me shkrim të Thaçit, para. 14-15.

mundur nxjerrjen e tabelës përkatëse duke eksportuar meta të dhënat përkatëse të regjistruara për çdo provë.<sup>39</sup> Tabela përmbledhëse mund të nxirret nga secila palë brenda 15 ditësh pas paraqitjes së dosjes paraprake.<sup>40</sup>

34. Sa i përket sistemit të redaktimit, Mbrojtja e z. Thaçi nuk e kundërshton miratimin e sistemit që është aktualisht në përdorim në çështjen *Mustafa*.<sup>41</sup>

### 3. Mbrojtja e z. Veseli

35. Në këtë fazë, Mbrojtja e z. Veseli nuk kundërshton asnjë nga propozimet e ZPS-së në lidhje me nxjerrjen e provave dhe procedurën përkatëse, por rezervon të drejtën të bëjë parashtrime të tjera në konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes.<sup>42</sup>

### 4. Mbrojtja e z. Selimi

36. Sa i përket nxjerrjes së provave, Mbrojtja e z. Selimi parashtron se nëse nuk kërkohen redaktime për disa nga materialet e rregullës 102(1)(a) të Rregullores, ky material duhet t'i jepet Mbrojtjes para afatit prej 30 ditësh të paraparë në të njëjtën dispozitë.<sup>43</sup>

37. Lidhur me materialin e rregullës 102(1)(b), Mbrojtja e z. Selimi ngjashëm parashtron se nxjerrja e provave që nuk kanë nevojë për redaktim, duhet të fillojë më herët se afati i propozuar nga ZPS-ja dhe vetëm në rrethana të veçanta duhet të nxirret 30 ditë para hapjes së çështjes prej ZPS-së.<sup>44</sup>

---

<sup>39</sup> Parashtrimet me shkrim të Thaçit, para. 19.

<sup>40</sup> Parashtrimet me shkrim të Thaçit, para. 20.

<sup>41</sup> Parashtrimet me shkrim të Thaçit, para. 21.

<sup>42</sup> Parashtrimet me shkrim të Veselit, para. 13-14.

<sup>43</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 13.

<sup>44</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 19-20.

38. Sa i përket materialit të rregullës 102(3), Mbrojtja e z. Selimi parashtron se provat e marra nga i akuzuari ose që i përkasin atij duhet të nxirren menjëherë dhe, më së voni, së bashku me materialin mbështetës të Aktakuzës së Konfirmuar.<sup>45</sup> Për më tepër, Mbrojtja e z. Selimi pretendon se ZPS-ja duhet t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3) brenda tri ditëve të punës, ose edhe më herët nëse është e nevojshme prej llojit të kërkesës.<sup>46</sup> Nëse ZPS-ja e pranon kërkesën për nxjerrjen e materialit, ajo duhet t'ia japë materialin Mbrojtjes brenda dy ditësh.<sup>47</sup>

39. Për materialin e rregullës 103, Mbrojtja e z. Selimi parashtron se kur nxjerr material të tillë ZPS-ja duhet të shpjegojë se si secila provë është shfajësuese duke iu referuar paragrafit përkatës në Aktakuzën e Konfirmuar, dëshmitarit përkatës, apo provave të tjera shkresore me të cilat ka lidhje.<sup>48</sup> Për më tepër, ajo pretendon se mosnxjerrja e materialit shfajësues për shkak të dijenisë së Mbrojtjes për atë material përmes ushtrimit të zellit të duhur jo domosdoshmërisht mund të vlejë për të gjithë të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre.<sup>49</sup>

40. Sa i përket procedurës për nxjerrjen e provave, Mbrojtja e z. Selimi e kundërshton propozimin e ZPS-së që të japë vetëm një tabelë përmbledhëse të nxjerrjes së materialit një javë nga dita e paraqitjes së dosjes paraprake.<sup>50</sup> Ajo argumenton se paraqitja e tabelave të nxjerrjes së materialit për secilën paketë materialesh të rregullës 102(1)(b) është mënyra e vetme që të sigurohet që Mbrojtja do të jetë në gjendje të vlerësojë në mënyrë të mirëfilltë provat e nxjerra.<sup>51</sup> Sa i përket formatit të tabelave të nxjerrjes së

---

<sup>45</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 22.

<sup>46</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 24.

<sup>47</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 24.

<sup>48</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 27.

<sup>49</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 28.

<sup>50</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 33.

<sup>51</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 34.

materialit, Mbrojtja e z. Selimi parashtron se mundësitë e *Legal WorkFlow* duhet të jenë bazë për çdo diskutim *inter partes* në lidhje me formatin.<sup>52</sup>

41. Lidhur me sistemin e redaktimit, Mbrojtja e z. Selimi e kundërshton miratimin e sistemit që është në përdorim aktualisht në çështjen *Mustafa*, veçanërisht mungesën e autorizimit gjyqësor paraprak për redaktime standarde.<sup>53</sup> Ajo argumenton se ky mekanizëm e kalon detyrimin e arsyetimit të çdo redaktimi nga ZPS-ja te Mbrojtja, e cila duhet të kërkojë heqjen e redaktimeve të vendosura pa mbikëqyrje gjyqësore.<sup>54</sup> Mbrojtja e z. Selimi gjithashtu parashtron se nuk e kundërshton procedurën e krijuar në çështjen *Mustafa* ku kërkesat për redaktime jostandarde paraqiten njëkohësisht me nxjerrjen e materialit të propozuar për redaktim, meqë kjo e lejon Mbrojtjen që të analizojë materialin e redaktuar në pritje të autorizimit gjyqësor të redaktimeve të propozuara.<sup>55</sup>

## 5. Mbrojtja e z. Krasniqi

42. Sa i përket nxjerrjes së provave, Mbrojtja për z. Krasniqi parashtron se nxjerrja e materialit të rregullës 102(1)(a) të Rregullores duhet të fillojë sa më parë që është e mundshme dhe të bëhet progresivisht, sidomos sa i përket materialit që nuk kërkon redaktime.<sup>56</sup>

43. Lidhur me materialin e rregullës 103, Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron se formulimi i rregullës 103 të Rregullores është i qartë dhe e ngarkon ZPS-në me detyrimin e nxjerrjes së çdo informacioni shfajësues që posedon, kontrollon ose ka dijeni aktuale për të, duke përfshirë edhe provat nga burimet e hapura.<sup>57</sup> Rrjedhimisht,

---

<sup>52</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 36.

<sup>53</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 37-40, 42.

<sup>54</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 39.

<sup>55</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 41.

<sup>56</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 9.

<sup>57</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 11.

nuk duhet të ketë nevojë që ZPS-ja të bëjë vlerësim nëse Mbrojtja mund të gjejë prova shfajësuese apo jo me ushtrimin e zellit të duhur.<sup>58</sup>

44. Sa i përket procedurës për nxjerrjen e provave, ndërsa pajtohet me përdorimin e tabelës së hollësishme për nxjerrjen e informacionit të propozuar nga ZPS-ja, Mbrojtja e Krasniqit pretendon se ato tabela duhet të përgatiten për secilën paketë të nxjerrjes së materialeve dhe jo vetëm në fund të procesit të nxjerrjes së materialit pas dorëzimit të dosjeve paraprahe nga palët.<sup>59</sup>

45. Për sistemin e redaktimit, në parashtrimet e veta me shkrim, Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron se miratimi gjyqësor duhet të kërkohet për çdo redaktim, dhe jo vetëm për redaktimet jostandarde, siç propozon ZPS-ja.<sup>60</sup> Ajo parashtron se miratimi për redaktime është pasojë natyrale e parimit se redaktimet janë përjashtime dhe duhet të jenë rreptësisht të domosdoshme.<sup>61</sup> Në konferencën për ecurinë e çështjes, Mbrojtja për z. Krasniqi bëri të ditur se nuk e kundërshton sistemin e redaktimit të miratuar në çështjen *Mustafa*.<sup>62</sup>

#### IV. DISKUTIM

##### A. PARIMET QË RREGULLOJNË NXJERRJEN E PROVAVE

##### 1. Hyrje

46. Korniza ligjore e DHS-së parasheh disa hapa proceduralë që duhet të merren nga Gjykatësi i Procedurës Paraprahe, palët dhe mbrojtësi i viktimave, sipas rastit, në periudhën midis paraqitjes së parë të të akuzuarit dhe kalimit të dosjes Trupit Gjykues, në pajtim me rregullën 98 të Rregullores. Ndër hapat kritikë, është

<sup>58</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 11.

<sup>59</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 10.

<sup>60</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 13.

<sup>61</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 13.

<sup>62</sup> Transkripti i datës 18 nëntor 2020, f. 156, rreshtat 18-19.



përcaktimi i një sistemi për shkëmbimin të provave midis palëve dhe vënia në dijeni e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Miratimi i një sistemi që mundëson efikasitetin e procesit të nxjerrjes së informacionit është themelor për Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të arrijë baraspeshimin midis detyrës së tij për të mbrojtur interesa të caktuara, përfshirë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse dhe personave të tjerë të rrezikuar dhe detyrimit për të mbështetur të drejtat e të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit.<sup>63</sup>

## 2. Roli i palëve dhe Zyrës Administrative

47. Nxjerrja e provave, dhe detyrimet që dalin për palët sipas Rregullores, është proces që ndodh midis ZPS-së dhe Mbrojtjes. Ky proces duhet të organizohet dhe ndihmohet nga Zyra Administrative, duke vepruar si kanal komunikimi midis palëve dhe panelit,<sup>64</sup> përmes programit elektronik që është siguruar për këtë qëllim, siç është përcaktuar në rregullat 98(1)(b) dhe 109(a) të Rregullores. Palët i përmbahen Udhëzimit të Zyrës Administrative për ngarkimin e të dhënave në *Legal WorkFlow* gjatë nxjerrjes së provave në mënyrë elektronike.<sup>65</sup>

48. Në pajtim me nenin 34(1) të Ligjit dhe rregullën 24(1) dhe (2) të Rregullores, Administratori administron dokumentimin e plotë dhe të saktë të proceseve gjyqësore dhe ruan të gjitha provat dhe materialet e tjera të paraqitura gjatë proceseve gjyqësore, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë vendim dhe vendimet e ardhshme për

<sup>63</sup> Urdhër i caktimit të datës për konferencën mbi ecurinë e çështjes, para. 18. *Ngjashëm, ICC, Prosecutor v. Ntaganda, ICC-01/04-02/06-117-Red3, Pre-Trial Chamber II, [Redacted First Decision on the Prosecutor's Request for Redactions and Related Requests](#), 3 korrik 2014, para. 17, dhe referencat që përmban.*

<sup>64</sup> *Ngjashëm, ICC, Prosecutor v. Al Hassan, ICC-01/12-01/18-31-tENG, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Evidence Disclosure Protocol and Other Related Matters](#) ("Al Hassan Disclosure Decision"), 16 maj 2018, para. 36; Prosecutor v. Ongwen, ICC-02/04-01/15-203, Pre-Trial Chamber II, [Decision Setting the Regime for Evidence Disclosure and Other Related Matters](#) ("Ongwen Disclosure Decision"), 27 shkurt 2015, para. 10.*

<sup>65</sup> KSC-BD-18, Administratorja, Udhëzim për ngarkimin e të dhënave në Legal Workflow, 28 gusht 2019.

këtë çështje. Ky dokumentacion duhet të jetë në dispozicion të palëve dhe pjesëmarrësve, sipas rastit, objekt i kufizimeve të domosdoshme në lidhje me mbrojtjen dhe nivelin e konfidencialitetit, siç parashihet në nenet 23 dhe 58 të Ligjit, si dhe rregullat 80, 82, 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ose sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Në lidhje me këtë aspekt, kur nxjerrin prova, palët përcaktojnë nivelin e përshtatshëm të klasifikimit për secilën provë dhe i regjistrojnë provat si publike, përveçse kur ka arsye që t'i klasifikojnë ndryshe, në pajtim me rregullën 83(1) të Rregullores.<sup>66</sup>

### 3. Komunikimi i provave Gjykatësit të Procedurës Paraprake

49. Sa i përket kundërshtimit të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me komunikimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake të të gjitha provave që palët i japin njëra-tjetrës, kujtojmë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka për detyrë të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitje të shpejt për gjykim, siç kërkohet në nenin 39(1) dhe (13) të Ligjit dhe rregullën 95(2) të Rregullores. Këtu përfshihet edhe përgatitja e raportit për trupin gjykues mbi nxjerrjen e materialeve, siç është përcaktuar në rregullën 95(2)(b) të Rregullores. Për të përmbushur këtë detyrë, të gjitha provat e shkëmbyera midis palëve, pavarësisht nëse do të përdoren në gjykim, i komunikohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Ky komunikim ka për qëllim, në thelb, të ndihmojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të sigurojë nxjerrjen e provave në kushte të përshtatshme,<sup>67</sup> dhe nxjerrjen brenda afatit të përcaktuar të provave relevante, pavarësisht se a janë thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes ose mundësisht shfajësuese. Shqetësimi se trupi gjykues i caktuar mund të formojë opinionet e veta në bazë të provave të nxjerra është

---

<sup>66</sup> *Shih, ngjashëm, ICC, Prosecutor v. Yekatom, ICC-01/14-01/18-64-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of "Decision on Disclosure and Related Matters"](#), ("Yekatom Disclosure Decision") 23 janar 2019, para. 17.*

<sup>67</sup> *Ngjashëm, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 12; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 14.*

e paarsyetuar. Gjatë gjykimit, palët janë të lira të mbështeten në prova të zgjedhura prej tyre, kurse trupi gjykues, i përbërë nga gjykatës profesionistë, mundet vetëm të vlerësojë provat e pranuar para tij në gjykim. Së fundi, çdo provë e nxjerrë që nuk synohet të përdoret në gjykim do të reflektohet në mënyrë të duhur në dokumentin dorëzues sipas rregullës 98(1)(e) të Rregullores.

50. Duke mbajtur parasysh faktorët e lartpërmendur, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të ketë qasje në këto prova të nxjerra: (a) të gjitha provat në të cilat mbështetet ZPS-ja për të arsyetuar Aktakuzën e Konfirmuar, përfshirë deklaratat e marra nga të akuzuarit, nëse ka (rregulla 102(1)(a) e Rregullores); (b) të gjitha deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim (rregulla 102(1)(b)(i) të Rregullores); (c) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet ose transkriptet që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 102(1)(b)(ii) e Rregullores); (d) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 102(1)(b)(iii) e Rregullores); (e) të gjitha provat që vlerësohen nga Mbrojtja juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit (rregulla 102(3) e Rregullores); (f) të gjitha provat shfajësuese që ZPS-ja i ruan, kontrollon ose di për to, duke përfshirë edhe njoftimet për materialin nga burimet e hapura në paragrafin 67 të këtij vendimi (rregulla 103 e Rregullores); (g) të gjitha provat që Mbrojtja mund t'i paraqesë për të vërtetuar një alibi ose arsye që përjashton përgjegjësinë penale, përfshirë emrat dhe të dhënat aktuale të dëshmitarëve, dhe çfarëdo prove tjetër në të cilën i akuzuari synon të mbështetet për të vërtetuar këtë alibi ose arsye (rregulla 104(1)(a) dhe (b) e Rregullores); (h) të gjitha provat që Mbrojtja i ka në ruajtje ose nën kontroll, që mund të këqyren nga ZPS-ja dhe Mbrojtja synon t'i përdorë në gjykim (rregulla 104(5)(a) e Rregullores); (i) të gjitha deklaratat, nëse ka, të dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim ose synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (j) të gjitha provat materiale, nëse ka, që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 104(5)(c) e Rregullores).

#### 4. Afatet për nxjerrjen e materialeve

51. Sipas kornizës ligjore të DHS-së, nxjerrja e disa kategorive të materialeve është objekt i afateve të sakta që parashihen Rregullore, ndërsa për kategoritë e tjera të materialit, përcaktimi i afateve të përshtatshme për nxjerrje të materialit i lihet Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke pasur parasysh veçantitë e çështjes, vëllimit dhe llojit të provave shkresore dhe parashtrimet e palëve.

52. Megjithëse vendimi aktual përcakton kalendarin për nxjerrjen e provave të kategorive të ndryshme, këto afate sugjerojnë afatin minimal për dhënien e njoftimit. Kur është e mundur, pala që bën nxjerrjen e materialit, duhet të përpiqet të nxjerrë materialin përpara afateve të përcaktuara për të lejuar përgatitjen e mirëfilltë nga pala që merr materialin.<sup>68</sup>

#### 5. Plotësia dhe rëndësia e provave të nxjerra

53. Secila palë mundëson që provat e nxjerra të jenë të plota. Provat që janë nxjerrë padashur në formë jo të plotë mund të nxirren përsëri brenda afatit që parashihet në Rregullore, ose sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

54. ZPS-ja dhe Mbrojtja, nëse kjo e fundit dëshiron, nxjerrin vetëm provat me rëndësi të mirëfilltë që mbështesin pretendimet në lidhje me fakte konkrete që plotësojnë kriteret ligjore të nevojshme, e jo të nxjerrin sa më shumë prova, për të lejuar palën që merr provat që të përqendrohet në përgatitjet e veta.<sup>69</sup>

---

<sup>68</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 37. Ngjashëm, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 13; [Al Hassan Disclosure Decision](#), paragrafët 20-21.

<sup>69</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 39. Ngjashëm, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 18; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 25; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 20.

## B. AFATET PËR NXJERRJEN E PROVAVE

### 6. Rregulla 102(1)(a): Materiali mbështetës për Aktakuzën

55. Rregulla 102(1)(a) e Rregullores trajton nxjerrjen e materialit në të cilin mbështetet ZPS-ja për të argumentuar Aktakuzën e Konfirmuar, përfshirë deklaratat e marra nga të akuzuarit. Ky material duhet të nxirret sa më parë që është e mundshme, po së paku brenda 30 ditësh pas paraqitjes së parë të të akuzuarit.

56. Gjatë përcaktimit të afatit për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a), Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh: (i) parashtimet e palëve, veçanërisht propozimin për të marrë provat në paketa sa më parë që është e mundshme;<sup>70</sup> (ii) kohën e nevojshme për të vendosur në lidhje me kërkesën e ZPS-së për masa mbrojtëse; (iii) kohën e nevojshme për ZPS-në për të kryer redaktimet, nëse i miratohet, dhe përgatitjen e materialit për nxjerrje; dhe (iv) kohën që i duhet ZPS-së për të identifikuar dhe përgatitur materialin që nuk ka nevojë për redaktime për nxjerrje të menjëhershme dhe pasojat e kësaj për respektimin e afatit prej 30 ditësh.<sup>71</sup> Rrjedhimisht, është e përshtatshme që si afat për të përfunduar nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a), të caktohet e premtja, 11 dhjetor 2020.

### 7. Rregulla 102(1)(b): Materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim

57. Rregulla 102(1)(b) e Rregullores trajton nxjerrjen e çfarëdo materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim, të cilin ZPS-ja nuk e ka përdorur si material mbështetës për aktakuzën që ka paraqitur për konfirmim. Ky material duhet të nxirret brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe sido që të jetë, jo më

---

<sup>70</sup> Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 123, rreshtat 23-25.

<sup>71</sup> Parashtimet me shkrim të ZPS-së, para. 7; Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 119, rreshtat 8-14.

vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga ZPS-ja, në përputhje me rregullën 124 të Rregullores.

58. Afati për nxjerrjen e një materiali të tillë mund të varet nga faktorë si: (i) sasia dhe lloji i materialit që do të nxirret; (ii) kur është mbledhur materiali nga ZPS-ja; (iii) nevoja për të kryer veprime hetimore (duke përfshirë edhe marrjen e lejeve të domosdoshme nga dhënësit e informacionit) para nxjerrjes së këtij materiali; (iv) nevoja për të përkthyer këtë material ose pjesë të tij, sidomos deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar; dhe (v) nevoja për të zbatuar masa mbrojtëse, përfshirë redaktimin e informacionit.<sup>72</sup>

59. ZPS-ja parashtron se materiali i rregullës 102(1)(b), pavarësisht nëse ka nevojë për redaktim ose jo, do të nxirret progresivisht, nëse dhe kur të jetë në dispozicion, deri në afatin e përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>73</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron që afatet mujore për nxjerrjen e këtij materiali nuk janë të domosdoshme, dhe do të ishte e preferueshme që kalendari konkret i nxjerrjes së paketave me material të tillë t'i të informacionit të përcaktohet sipas gjykimit të ZPS-së.<sup>74</sup>

60. Për arritjen e baraspeshimit midis gjykimit të ZPS-së për të vendosur se cili material i rregullës 102(1)(b) është i gatshëm për nxjerrje, në njërën anë, dhe për të mundësuar lëshimin në kohë të vendimeve për masa mbrojtëse, me qëllim që Mbrojtja të marrë prova progresivisht, në anën tjetër, është e përshtatshme që të përpilohet një kalendar për nxjerrjen e kësaj kategorie materiale. Për rrjedhojë, ZPS-ja do t'i paraqesë kërkesat e veta për masa mbrojtëse, nëse ka, deri të premtën, 8 janar; të premtën, 5 shkurt; të premtën, 5 mars; të premtën, 2 prill; dhe të premtën, 7 maj 2021, dhe të nxjerrë material të tillë me redaktime, nëse i miratohet, brenda dy javësh nga dita e vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për masa mbrojtëse. Për sasinë

---

<sup>72</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 45.

<sup>73</sup> Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 125, rreshtat 17-24, f. 129, rreshti 16.

<sup>74</sup> Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 129, rreshti 22 to f. 130, rreshti 4.

e materialit që është objekt i kërkesave mujore për masa mbrojtëse, sasinë e materialit që nuk ka nevojë për redaktime dhe kalendarin për nxjerrjen e materialit, i lihet ZPS-së të vendosë sipas gjykimit të vet. Sidoqoftë, nxis ZPS-në që, për aq sa është e realizueshme të nxjerrë sasi të barabartë të materialit çdo muaj, e jo të nxjerrë paketa të materialit që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në sasi. Nxjerrja e materialit të rregullës 102(1)(b) duhet të përfundohet deri të hënën, 31 maj 2021, siç është propozuar nga ZPS-ja.

61. Sa i përket kërkesës së disa ekipeve të Mbrojtjes që ZPS-së t'i caktohet afati i fundit për detyrimet e nxjerrjes së materialit,<sup>75</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se korniza ligjore e DHS-së parasheh nxjerrje të materialeve shtesë, megjithëse në rrethana të veçanta, pas afateve të përcaktuara në Rregullore, përfshirë edhe afatin e përcaktuar në rregullën 102(1)(b) të Rregullores.<sup>76</sup> Për këtë arsye, nëse ZPS-ja dëshiron të nxjerrë deklarata shtesë të dëshmitarëve të cilët synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, por nuk ka arritur ta bëjë këtë brenda afateve të përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, në nxjerrje të tilla të vonuara të materialit duhet të përmbushen kriteret e rregullës 102(1), (2) dhe (4) të Rregullores, përfshirë edhe për përkthimin. Në veçanti, duke pasur se nxjerrja e vonuar e materialit është përjashtim, ZPS-ja e përdor këtë vetëm si masë të fundit dhe jep arsye të mirëfillta për nxjerrjen e vonuar të materialit për secilën provë. Mbrojtja mund t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake në qoftë se ekzistojnë arsye për të kundërshtuar nxjerrjen e vonuar të materialeve.

---

<sup>75</sup> Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 128, rreshtat 22-24; f. 129, rreshtat 4-6.

<sup>76</sup> Rregulla 102(2) e Rregullores.



## 8. Rregulla 102(3): Provat juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të marra nga i akuzuari ose që i përkasin atij

62. Materiali i rregullës 102(3) përfshin provat që konsiderohen juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të cilat i ka ZPS-ja në ruajtje ose kontroll, ose që i janë marrë apo i kanë përkatur të akuzuarit. Shprehja *juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes* interpretohet gjerësisht dhe u referohet të gjitha dokumenteve dhe objekteve që janë të rëndësishme për përgatitjen e çështjes nga Mbrojtja, në ushtrim të të drejtave të të akuzuarit sipas Ligjit dhe Rregullores.<sup>77</sup> Çfarë është *relevante* në këtë aspekt nuk duhet detyrimisht të kufizohet nga kuadri kohor që mbulon Aktakuza e Konfirmuar e as nuk duhet të kufizohet vetëm në materialin relevant për kundërshtimin e provave të ZPS-së.<sup>78</sup> *Përgatitja* e Mbrojtjes gjithashtu është koncept i gjerë dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në ato që janë të lidhura drejtpërdrejt me provat inkriminuese ose shfajësuese,<sup>79</sup> ose të lidhur me provat e paraqitura nga ZPS-ja.<sup>80</sup>

63. Siç është përcaktuar shprehimisht në rregullën 102(3) të Rregullores, argumentet për rëndësinë materiale të provave materiale të tilla bëhen nga Mbrojtja, bazuar në strategjinë e çdo ekipi, dhe nuk varet nga vlerësimi i ZPS-së në emër të Mbrojtjes. Për këtë qëllim, ZPS-ja përgatit dhe nxjerr pa vonese njoftim të hollësishëm të të gjithë materialit dhe provave që ka në posedim, siç është përcaktuar me rregullën 102(3) të Rregullores. ZPS-ja mund t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake kur ka arsye

<sup>77</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 50. Ngjashëm, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/AC/AR126.4, F0004, Appeals Chamber, [Public Redacted Version of 19 September Decision on Appeal by Counsel for z. Oneissi Against Pre-Trial Judge's "Decision on Issues Related to the Inspection Room and Call Data Records"](#), ("2 October 2013 Decision") 2 tetor 2013, para. 21, dhe referencat që përmban; ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1433 (OA 11), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of z. Lubanga Dyilo against the Oral Decision of Trial Chamber I of 18 January 2008](#), ("11 July 2008 Judgment") 11 korrik 2008, para 77-78; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1330 (OA 3), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of z. Bosco Ntaganda against the "Decision on Defence requests seeking disclosure orders and a declaration of Prosecution obligation to record contacts with witnesses"](#), 20 maj 2016, para. 23, dhe referencat që përmban.

<sup>78</sup> Ngjashëm, [2 October 2013 Decision](#), para. 22, dhe referencat që përmban.

<sup>79</sup> Ngjashëm, [11 July 2008 Judgment](#), para. 77.

<sup>80</sup> Ngjashëm [2 October 2013 Decision](#), para. 22, dhe referencat që përmban.

për të kundërshtuar rëndësinë materiale të informacionit, sipas pretendimit të Mbrojtjes në bazë të njoftimit të hollësishëm nga ZPS-ja.

64. Gjatë përcaktimit të afateve për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3), Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh: ((i) parashtrimet e palëve; (ii) sasinë e madhe e provave që mund të hyjë në këtë kategori (afërsisht 100000); (iii) kohën e nevojshme për Mbrojtjen që të shqyrtojë njoftimin e hollësishëm të dhënë nga ZPS-ja; (iv) nevojën për redaktimin e një përqindje të konsiderueshme të provave të rregullës 102(3) që do të nxirren; dhe (v) nevojën për të siguruar që nxjerrja e materialit të kryhet shpejt.

65. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se kalendari i propozuar nga Mbrojtja e z. Selimi<sup>81</sup> mund të jetë barrë e rëndë për ZPS-në dhe panelin, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se nuk dihet sa prova janë të cilat Mbrojtja do të kërkojë të ketë qasje shohë ose t'i këqyrë. Për këtë arsye, është e përshtatshme që afati për ZPS-në që t'i japë Mbrojtjes njoftimin e hollësishëm të materialit sipas rregullës 102(3), të caktohet për të premtën, 30 prill 2021. Pas kësaj, Mbrojtja do t'i bëjë me dije ZPS-së deri të hënën, 14 qershor 2021, ose kurdo qoftë më herët, se në cilat prova materiale të përfshira në njoftimin e hollësishëm duan të kenë qasje, përmes nxjerrjes ose këqyrjes së tyre. Në bazë të këtyre të dhënave, jo më vonë se të hënën, 5 korrik 2021, ose brenda tri javësh nga njoftimi i Mbrojtjes, në cilëndo datë të mëhershme, ZPS-ja: (i) nxjerr ose lejon qasje në materialin e zgjedhur që nuk ka nevojë për redaktim; dhe (ii) paraqet kërkesë për masa mbrojtëse, nëse do të ketë, në lidhje me materialin e kërkuar nga Mbrojtja. ZPS-ja i jep Mbrojtjes materialin për të cilin janë miratuar redaktimet sa më shpejt që është e mundur pas marrjes së vendimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me masat mbrojtëse të kërkuara. Nëse ZPS-ja dëshiron të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave të kërkuara nga Mbrojtja, i drejtohet panelit brenda 10 ditësh nga njoftimi i Mbrojtjes.

---

<sup>81</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para.24.

## 9. Rregulla 103: Provat shfajësuese

66. Materiali i rregullës 103 (provat shfajësuese) përfshin çfarëdo informacioni që është nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së, për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së. Kushti që ZPS-ja t'i nxjerrë provat shfajësuese *menjëherë, sapo të jenë* nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të saj, vë në dukje detyrimin e përhershëm të ZPS-së që t'i japë një material të tillë Mbrojtjes, përveçse kur arsye përligjëse parandalojnë nxjerrjen e menjëhershme të informacionit.<sup>82</sup> I takon ZPS-së që të bëjë vlerësimin fillestar nëse një informacion i caktuar është ose nuk është shfajësues dhe duhet të bëhet me ndershmëri.<sup>83</sup>

67. Sa i përket kërkesës së ZPS-së për t'u liruar nga detyrimi për nxjerrjen e provave nga burimet e hapura kur një material i tillë është i ditur dhe Mbrojtja mund ta gjejë duke ushtruar zellin e duhur,<sup>84</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se sistemi i propozuar nga ZPS-ja i jep asaj hapësirë gjykimi të tepruar për të vendosur çfarë material i përjashtohet nga nxjerrja në përputhje me rregullën 103 të Rregullores. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të provave në këtë çështje, do të ishte një mënyrë veprimi e ndershme dhe e shpejtë që ZPS-ja ta njoftojë Mbrojtjen dhe Gjykatësin e Procedurës Paraprake, përmes parashtrimeve, për të gjitha materialet nga burimet e hapura në lidhje me të cilat dëshiron të përjashtohet nga detyrimi i nxjerrjes së materialit sipas rregullës 103 të Rregullores. Njoftime të tilla duhet të përmbajnë burimet e sakta, për shembull

---

<sup>82</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para, para. 54; *Ngjashëm*, ICTR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Decision on Motions Relating to the Appellant Hassan Ngeze's and the Prosecution's Request for Leave to Present Additional Evidence of Witness ABC1 and EB](#) ("27 November 2006 Decision"), 27 nëntor 2006, para. 11, dhe referencat që përmban. *Shih gjithashtu*, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 16; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 18.

<sup>83</sup> *Ngjashëm*, [27 November 2006 Decision](#), para. 11, dhe referencat që përmban.

<sup>84</sup> Parashtrimet me shkrim të ZPS-së, para. 18; Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 132, rreshtat 3-14.

adresën e internetit, ku mund të gjenden materialet. Nëse Mbrojtja nuk është në gjendje të ketë qasje ose të gjejë një apo më shumë prova në njoftimin ose njoftimet, ajo e informon ZPS-në *inter partes*. Në këtë rast, ZPS-ja nxjerr materiale të tillë për të gjitha ekipet e Mbrojtjes sa më parë që është e mundur. Në rast të mosmarrëveshjeve, palët i drejtohen menjëherë panelit.

68. Sa i përket materialit që nuk hyn në përjashtimin e lartpërmendur, ZPS-ja duhet t'i nxjerrë, siç është bërë e ditur,<sup>85</sup> mbi 1000 prova potencialisht shfajësuese jo më vonë se të premtën, 11 dhjetor 2020, dhe të gjitha paketat e tjera të materialeve të rregullës 103 sa më parë që është e realizueshme dhe progresivisht, veçanërisht nëse materiali nuk ka nevojë për redaktime. Nëse paketa të materialit që mund të jetë shfajësues ka nevojë për redaktime, ZPS-ja së pari i drejtohet panelit sa më parë që të ketë mundësi për vendim në lidhje me këtë çështje, për ta lehtësuar nxjerrjen e menjëhershme të materialit të tillë për Mbrojtjen.

#### **10. Rregulla 107: Materiali i mbrojtur**

69. Rregulla 107 e Rregullores, së bashku me nenin 58 të Ligjit, rregullojnë nxjerrjen e materialit që i është dhënë ZPS-së në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja. Një material i tillë, në parim, nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit, përveçse me pëlqimin e dhënësit të informacionit.

70. Kur materiali i mbrojtur është objekt i nxjerrjes së informacionit sipas rregullës 102 dhe/ose 103 të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* panelit për t'u liruar plotësisht ose pjesërisht nga detyrimi për nxjerrjen e materialit në fjalë. ZPS-ja gjithashtu mund të kërkojë për masa kompensuese në përputhje me rregullën 108(2) të Rregullores.

---

<sup>85</sup> Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 131, rreshtat 21-23.

71. Duke pasur parasysh se ZPS-ja kërkon aktivisht leje për material që mund të jetë i rregullës 102(3) të Rregullores,<sup>86</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kujton ZPS-në që ta informojë Gjykatësin të Procedurës Paraprake për çfarëdo problemi në lidhje me lejet e kërkuara.

#### C. NXJERRJA E PROVAVE NGA MBROJTJA

72. Parimet dhe procedurat e shpallur në vendimin aktual vlejné njëlloj për Mbrojtjen, në varësi të detyrimeve përkatëse të Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake përkujton se detyrimet e Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit, në përputhje me rregullën 104 të Rregullores, vijnë në fuqi vetëm nëse Mbrojtja vendos të paraqesë prova dhe, në çdo rast, vetëm pasi ZPS-ja të ketë paraqitur dosjen paraprake dhe listën e dëshmitarëve që do të thirren në gjykim dhe provat materiale të propozuara, në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores.

73. Rrjedhimisht, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe pas paraqitjes prej ZPS-së të dosjes paraprake dhe listës së dëshmitarëve e provave materiale të propozuara, Mbrojtja do të ftohet të paraqesë dosjet paraprake përkatëse ku bën të ditur informacionin e kërkuar në rregullën 95(5) të Rregullores, pa cenuar të drejtën e Mbrojtjes për të shpallur synimin për t'u mbështetur në alibi, ose arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, në cilëndo datë të mëhershme.

74. Duke pasur parasysh se procesi i nxjerrjes së informacionit sapo ka filluar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të marrë vendime të tjera. Afatet që rregullojnë paraqitjen e dosjes paraprake dhe listën e dëshmitarëve dhe provave materiale të ZPS-së, të cilat pastaj i përcaktojnë afatet për paraqitjen e dosjeve

---

<sup>86</sup> Transkripti i datës 18 nëntor 2020, f. 141, rreshtat 9-12.

paraprake të Mbrojtjes dhe nxjerrjen e provave, nëse ka, gjithashtu do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme.

#### D. PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE PROVAVE

75. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet të sigurohet që provat, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve, të nxirren në anglishte, gjuhën e punës së procesit, siç është përcaktuar me nenin 20 të Ligjit dhe rregullën 8(3) të Rregullores.<sup>87</sup>

76. Në anën tjetër, neni 21(4)(a) i Ligjit përcakton që të akuzuarit duhet të informohen në një gjuhë që e kuptojnë për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tyre, në rastin konkret, në shqipe.<sup>88</sup> Sidoqoftë, kjo e drejtë nuk nënkupton të drejtën e pakufizuar dhe absolute për të marrë të gjitha provat, dokumentet dhe parashtrimet e protokolluara në gjuhën e të akuzuarve. Përkthimi i të gjithë dosjes së çështjes, përfshirë provat, do të cenonte të drejtën sipas nenit 21(4)(d) të Ligjit, për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.<sup>89</sup> Rrjedhimisht, duhet të arrihet një ekuilibër midis këtyre të drejtave konkurruese në mënyrë që procesi të jetë edhe njëkohësisht i drejtë dhe i shpejtë.

77. Si rezultat i sa më lart, Rregullorja përcakton se të gjitha deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, do të jetë në dispozicion

<sup>87</sup> Vendim për gjuhën e punës, para. 26(a).

<sup>88</sup> Në këtë kontekst, bëhet e ditur se të akuzuarit i kanë marrë Aktakuzën e Konfirmuar dhe fletarrestimet në shqipe (KSC-BC-2020-06, F00065/RED, *Administratorja, Raport për arrestimin dhe transferimin e Hashim Thaçit në objektin e paraburgimit*, 18 nëntor 2020, publik, para 7, 19, 28; F00070/RED, *Administratorja, Raport për arrestimin dhe transferimin e Kadri Veselit në objektin e paraburgimit*, 18 nëntor 2020, publik, paragrafët 7, 22, 30; F00071/RED, *Administratorja, Raport për arrestimin dhe transferimin e Rexhep Selimit në objektin e paraburgimit*, 18 nëntor 2020, publik, para 5, 20, 28; F00064/RED, *Administratorja, Raport për arrestimin dhe transferimin e Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit*, 18 nëntor 2020, publik, para. 5, 37-38.

<sup>89</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 66. Ngjashëm, [Ongwen Disclosure Decision](#), paragrafët 31-32; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-307, Pre-Trial Chamber III, [Decision on the Defence's Request Related to Language Issues in the Proceedings](#), 4 dhjetor 2008, para. 15.

në gjuhën që i akuzuari e kupton dhe e flet, siç kërkohet shprehimisht në rregullën 102(1) të Rregullores. Të gjitha provat e tjera paraqiten në anglishte, në pajtim me vendimin për gjuhën e punës, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ndryshe.

78. Ndihma falas e përkthyesit me gojë së bashku me këshillat profesionale të mbrojtësit, siç parashihet në nenin 21(4)(c) dhe (g) të Ligjit, e ndihmojnë të akuzuarin për të kuptuar provat dhe parashtrimet në lidhje me to që nuk janë në shqipe.<sup>90</sup>

#### E. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E PROVAVE

79. Materiali shoqërues i parashikuar në rregullën 109(b) dhe (c) të Rregullores përpilohet për t'i mundësuar më së miri palës marrëse që të njihet me materialin e nxjerrë dhe ta shqyrtojë atë, me qëllim që t'i përqendrojë përgatitjet dhe, më përgjithësisht, për një proces më të drejtë dhe më të shpejtë.<sup>91</sup>

80. Në konferencën për ecurinë e çështjes, palët e informuan Gjykatësin e Procedurës Paraprake se janë në kryerje e sipër diskutime *inter partes* për formatin dhe kalendarin e dhënies së tabelave për nxjerrjen e informacionit që përmbushin kriteret për kategorizim të rregullës 109(c) të Rregullores.<sup>92</sup> Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të përshtatshme që ta shtyjë vendimin në lidhje

<sup>90</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 68. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-56-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of "Decision on Language Proficiency of Alfred Yekatom for the Purposes of the Proceedings"](#), 11 janar 2019, para. 18; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 33.

<sup>91</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 69. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-47, Pre-Trial Chamber II, [Decision Setting the regime for Evidence Disclosure and Other Related Matters](#), 12 prill 2013, para. 31-32; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-55, Pre-Trial Chamber III, [Decision on the Evidence Disclosure System and Setting a Timetable for Disclosure between the Parties](#), 31 korrik 2008, para. 72-72.

<sup>92</sup> Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 143, rreshtat 1-13; f. 145, rreshti 19 to f. 146, rreshti 13; f. 146, rreshti 17 to f. 147, rreshti 4; f. 147, rreshti 16 to f. 149, rreshti 17; f. 149, rreshti 20 to f. 150, rreshti 3; f. 150, rreshtat 12-18; f. 151, rreshtat 11-16; f. 152, rreshtat 5, 8.



me këtë aspekt derisa të përfundojnë diskutimet midis palëve. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron ZPS-në që të paraqesë propozim të përbashkët në lidhje me formatin dhe kalendarin e tabelave për nxjerrjen e informacionit sipas rregullës 109(c) të Rregullores për këtë çështje gjyqësore deri të premtën, 27 nëntor 2020.

81. Sa i përket afatit të ardhshëm për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a), Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton se, duke e bazuar në qasjen që është miratuar në çështjen *Mustafa*,<sup>93</sup> ZPS-ja do të nxjerrë përmbledhjen e detajuar, me redaktime, nëse është e nevojshme.

#### F. KUFIZIMET PËR NXJERRJEN E INFORMACIONIT

##### 1. Parime të përgjithshme

82. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se nxjerrja e plotë e të gjitha materialeve dhe provave relevante është parim, ndërsa mosnxjerrja e informacionit është përjashtim.<sup>94</sup> Siç sugjeron leximi i kombinuar i nenit 21(6) të Ligjit dhe rregullave 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, çfarëdo kufizimi i nxjerrjes së plotë të informacionit duhet të jetë rreptësisht i domosdoshëm për mbrojtjen e: (i) sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët në DHS, me kusht që këto masa të përputhen me të drejtat e

---

<sup>93</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 72.

<sup>94</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 73. Shih gjithashtu, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-568 (OA3), Appeals Chamber, [Judgment on the Prosecutor's appeal against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "Decision Establishing General Principles Governing Applications to Restrict Disclosure pursuant to Rule 81 \(2\) and \(4\) of the Rules of Procedure and Evidence"](#) ("13 October 2006 Judgment"), 13 tetor 2006, paragrafët 1, 39; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-475 (OA), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements"](#) ("13 May 2008 Judgment"), 13 maj 2008, para. 70.

të akuzuarve; (ii) hetimet aktuale ose të ardhshme; dhe (iii) interesin publik dhe të drejtave të palëve të treta. Në këtë kontekst, kujtojmë se është e lejueshme mosnxjerrja për Mbrojtjen, e një informacioni të caktuar.<sup>95</sup>

83. Redaktimet që synojnë mbrojtjen e hetimeve aktuale ose të ardhshme ose të interesit publik dhe të drejtave të palëve të treta zbatohen vetëm me kërkesë të Prokurorit të Specializuar ose të Mbrojtjes, të paraqitura konfidencialisht dhe *ex parte*.<sup>96</sup> Redaktimet që synojnë mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët ,zbatohen me të cilësdo prej palëve, të paraqitura konfidencialisht dhe *ex parte* ose *proprio motu*.<sup>97</sup>

84. Së fundi, nevoja për redaktime duhet të vlerësohet rast pas rasti.<sup>98</sup> Në përcaktimin e sistemit të redaktimit që do të zbatohet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të bëjë balancimin midis interesave konkurruese, ndërsa siguron që procesi të jetë i drejtë dhe i shpejtë.<sup>99</sup>

## 2. Standardi ligjor

85. Gjatë vlerësimit nëse një informacion i caktuar mund të mos i jepet palës marrëse, duhet të përcaktohet nëse;<sup>100</sup>

<sup>95</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 73; [13 May 2008 Judgment](#), para. 68.

<sup>96</sup> Rregulla 108(1) dhe (6) e Rregullores.

<sup>97</sup> Rregulla 80(1) dhe (3) e Rregullores.

<sup>98</sup> [13 tetor 2006 Judgment](#), para. 36; [13 May 2008 Judgment](#), paragrafët 2, 59, 66.

<sup>99</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 75.

<sup>100</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 76. *Shih gjithashtu*, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-773 (OA5), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of z. Thomas Lubanga Dyilo against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Requests and Amended requests for Redactions under Rule 81"](#), 14 dhjetor 2006, paragrafët 21, 33-34; [13 May 2008 Judgment](#), paragrafët 95-99; ECtHR, *Rowe and Davis v. United Kingdom*, no. 2890/95, [Judgment](#), 16 shkurt 2000, para. 61; *Botmeh and Alami v. United Kingdom*, no. 15187/03, [Judgment](#), 7 June 2007, para. 37.

- (i) nxjerrja e informacionit në fjalë për palën marrëse, në ndryshim nga nxjerrja për publikun, paraqet rrezik objektivisht të arsyetueshëm për personin ose interesin e mbrojtur;
- (ii) masa mbrojtëse është absolutisht e domosdoshme.<sup>101</sup> Si rrjedhojë, nëse janë të mjaftueshme dhe të realizueshme masa mbrojtëse më pak kufizuese, duhet të zgjidhen masa mbrojtëse të tilla; dhe
- (iii) masa mbrojtëse është proporcionale kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykimit të drejtë.<sup>102</sup>

### 3. Sistemi i redaktimit

86. Me qëllim të shpejtimit të procesit dhe krijimit të një sistemi efikas, të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm për redaktime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se është e përshtatshme të miratojë sistemin e zbatuar në çështjen *Mustafa*, në varësi të ndryshimeve të përcaktuara në këtë vendim. Me lëshimin e këtij vendimi, palët kanë udhëzime të mjaftueshme për zbatimin e redaktimeve, nëse ka, para nxjerrjes së provave që posedojnë.

87. Sipas këtij sistemi, provat mund të nxirren nga cilado palë me redaktime të bëra drejtpërdrejt për kategori të paracaktuara të informacionit (“redaktime standarde”) pa autorizim gjyqësor paraprak. Në këtë rast, pala që bën nxjerrjen e informacionit nuk është e detyruar që të paraqesë kërkesë të veçantë. Pala marrëse ka të drejtë të kundërshtojë cilindo redaktim të zbatuar pas nxjerrjes së provave.<sup>103</sup>

88. Për redaktimet që janë jashtë kategorive të paracaktuara të përmendura më lart (“redaktimet jostandarde”), pala që nxjerr informacionin duhet t’i paraqesë kërkesë të

---

<sup>101</sup> Neni 21(6) i Ligjit.

<sup>102</sup> Rregulla 80(1) e Rregullores.

<sup>103</sup> *Shih më poshtë* para. 91.

veçantë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për autorizim për të kufizuar nxjerrjen e informacionit, sipas procedurës të përcaktuar më poshtë.<sup>104</sup>

89. Në rastin e të dy llojeve të redaktimeve, standarde dhe jostandarde, informacioni që nuk nxirret mund të nxihet, censurohet, ose të zëvendësohet me tekstin “[REDAKTUAR]”. Gjithashtu, pala që bën nxjerrjen e informacionit, bën të ditur llojin e redaktimit në kutinë e redaktimit ose në çfarëdo vendi të përshtatshëm duke përdorur kod specifik si në listën më poshtë, përveçse kur një shënim i tillë do të binte ndesh me qëllimin e redaktimit. Ky format do ta lejojë lexuesin që ta njohë menjëherë llojin e informacionit që është redaktuar ose hequr dhe arsyetimin përkatës. Në rast se informacioni i redaktuar i takon më shumë se një kategori, duhet të shënohen të gjitha kodet përkatëse.

90. Kur nxirret informacioni me redakte, pala që bën nxjerrjen e informacionit i cakton pseudonim të veçantë çdo personi identiteti i të cilit është redaktuar sipas kategorive A.3 dhe A.4, siç është përcaktuar më poshtë, që shoqërojnë kodet përkatëse të redaktimit. Qëllimi i pseudonimeve të tilla është që t’i mundësojë lexuesit të materialit të redaktuar të identifikojë nëse është fjala për të njëjtin person që është përmendur në disa prova materiale. Pala që bën nxjerrjen e materialit nuk ka nevojë të japë kodin e kategorisë dhe/ose pseudonimin kur kjo bie ndesh me qëllimin e redaktimit, por bën të qartë se cilat kode/pseudonime janë hequr për këtë arsye.

91. Pala marrëse mund të kundërshtojë çfarëdo redaktimi konkret për të cilin mendon se është i papërligjur, ose nëse mendon se një redaktim konkret duhet të hiqet si rezultat i rrethanave të ndryshuara. Për këtë qëllim ajo i drejtohet drejtpërdrejt palës që bën nxjerrjen e informacionit. Palët konsultohen në mirëbesim për të sqaruar çështjen. Nëse palët nuk janë në gjendje të pajtohen, pala marrëse mund t’i bëjë kërkesë pa vonesë të panevojshme Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të vendosë,

---

<sup>104</sup> *Shih më poshtë para. 97.*

duke krijuar kështu detyrim për palën që nxjerr informacionin, për të arsyetuar redaktimin në fjalë. Në këtë rast, pala që bën nxjerrjen e informacionit e dorëzon përgjigjen e saj në dokumentacionin e çështjes brenda pesë ditësh pas kundërshtimit, përveçse kur vendoset ndryshe nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

92. Pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet të monitorojë nevojën e vazhdueshme për redaktime dhe rinxjerr prova me më pak redaktime pa kërkuar paraprakisht leje nga paneli përkatës menjëherë pasi arsyet që justifikojnë redaktimet nuk ekzistojnë më, ose, nëse është e zbatueshme, bën kërkesë sipas rregullës 81(1) dhe (2) të Rregullores. Redaktimet mund të hiqen edhe pas: (i) marrëveshjes midis palëve se nuk ekziston më rrezik objektivisht i identifikueshëm për personin ose interesin në fjalë; ose (ii) urdhrorit nga paneli kompetent. Nëse informacioni i redaktuar i takon më shumë se një kategori, redaktimet duhet të hiqen pas përfundimit të të gjitha afateve përkatëse. Nëse pala që nxjerr informacionin dëshiron t'i mbajë redaktimet edhe pas kalimit të afatit për heqjen e tyre, ajo duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

93. Për të verifikuar sipas gjykimit të tij, vlefshmërinë e çfarëdo redaktimi të zbatuar nga pala që bën nxjerrjen e informacionit dhe, nëse është e nevojshme, për të urdhëruar palën që bën nxjerrjen e informacionit *proprio motu* të heqë, pjesërisht ose plotësisht, çfarëdo redaktimi, pasi t'i ketë dhënë mundësi palës që bën nxjerrjen e informacionit që të paraqesë vërejtjet e veta, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se është e përshtatshme që të marrë provat në formën që i janë dhënë palës marrëse, si dhe në formë të paredaktuar.<sup>105</sup> Kjo i mundëson Gjykatësit të Procedurës Paraprake që, në përputhje me rregullat 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, të verifikojë shkallën dhe vlefshmërinë e çfarëdo redaktimi, duke shtuar kështu edhe një nivel të rishikimit në të mirë të palës marrëse. Kjo i mundëson Gjykatësit të Procedurës

---

<sup>105</sup> Kjo e fundit duhet të jetë në dispozicion në sistemin elektronik të administrimit vetëm për Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe për palën që bën nxjerrjen e informacionit. *Ngjashëm, Al Hassan Disclosure Decision*, para. 32; *Yekatom Disclosure Decision*, para. 28.

Paraprake që të reagojë shpejt nëse ka kundërshtime në lidhje me redaktimet e zbatuara, sipas rastit. Kjo nuk e paragjykon faktin që pala që bën nxjerrjen e informacionit mund të mbështetet vetëm në formën e redaktuar të provave, siç i janë dhënë palës marrëse.

#### 4. Redaktimet standarde

94. Kategoritë për redaktime standarde janë të ndara qartë dhe të rrënjësura në praktikat e gjykatave të tjera<sup>106</sup> dhe janë miratuar në çështjen *Mustafa*.<sup>107</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake këtu miraton kategoritë e mëposhtme të redaktimeve standarde dhe arsyetimet e tyre duke pasur parasysh standardin e shtjelluar më lart. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, nxjerrja e informacionit e kategorizuar më poshtë për palën marrëse rregullisht nënkupton rrezik objektivisht të identifikueshëm për interesat në fjalë dhe kërkon miratimin e masave mbrojtëse që janë absolutisht të domosdoshme, gjithmonë duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarve dhe drejtësinë e gjykimit.

95. Kategoritë e informacionit që mund të redaktohen nga pala që bën nxjerrjen e informacionit pa autorizim gjyqësor paraprak janë:

(a) *Redaktimet sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores:*

**Kategoria "A.1":** Vendndodhjet e intervistave dhe të akomodimit, nëse nxjerrja e informacionit në lidhje me to mund të tërheqë vëmendjen në mënyrë të papërshtatshme ndaj lëvizjeve të palëve, personelit, viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të Dhomave të Specializuara, duke krijuar në këtë mënyrë rrezik objektiv për hetime aktuale apo hetime të ardhshme. Në parim, ky informacion nuk është i rëndësishëm për palën tjetër. Redaktime të tilla hiqen kur vendi nuk përdoret më në hetimet aktuale dhe të ardhshme.

---

<sup>106</sup> Për shembull, [Yekatom Disclosure Decision](#), para 25-26; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 29.

<sup>107</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 86.

**Kategoria "A.2":** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të personelit ose kontraktuesve të palëve, Zyrës Administrative ose Dhomave të Specializuara (duke përjashtuar hetuesit), të cilët udhëtojnë shpesh në terren ose janë të vendosur atje, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikonte këta persona dhe/ose të pengonte punën e tyre, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale dhe të ardhshme (saktësohet më tej në "A.2.1." për përkthyesit me shkrim dhe gojë, "A.2.2." për stenografët, "A.2.3" për ekspertët psiko-socialë, "A.2.4" për ekspertët e tjerë mjekësorë, "A.2.5." për pjesëtarët e tjerë të personelit që hyjnë në këtë kategori, dhe "A.2.6." për kontraktuesit e tjerë që hyjnë në këtë kategori).

**Kategoria "A.3":** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të hetuesve, duke mbajtur parasysh se palët kanë një numër të kufizuar hetuesish, nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikojë ata dhe pengojë punën e tyre në terren, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale ose të ardhshme, ose rrezikon sigurinë e dëshmitarëve ose personave të tjerë që ata intervistojnë ose kontaktojnë. Në pajtim me paragrafin 90 më lart, pala që bën nxjerrjen e informacionit e shënon pseudonimin unik të hetuesit, si dhe kodin e kategorisë (p.sh. "A.3.1.", "A.3.2.", "A.3.3.", etj.)

**Kategoria "A.4":** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të ndërmjetësuesve, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikojë këta persona dhe të pengojë punën e tyre në terren, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale ose të ardhshme, ose rrezikon sigurinë e dëshmitarëve ose personave me të cilët ata kanë kontakt. Në pajtim me paragrafin 90 më lart, pala që bën nxjerrjen e informacionit e shënon pseudonimin unik të ndërmjetësuesit, si dhe kodin e kategorisë (p.sh. "A.4.1.", "A.4.2.", "A.4.3.", etj.)

**Kategoria "A.5":** Të dhënat e identifikuese dhe të kontaktit të sinjalizuesve dhe burimeve, përfshirë dëshmitarët e mundshëm,<sup>108</sup> nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të çojë në frikësimin e dëshmitarëve ose në ndërhyrjet te ta, gjë që mund të dëmtojë hetimet aktuale ose të ardhshme (saktësohet më tej si "A.5.1." për sinjalizuesit dhe burimet individuale, përfshirë dëshmitarët e mundshëm, "A.5.2." për organizatat joqeveritare, "A.5.3." për organizatat ndërkombëtare, "A.5.4." për agjencitë shtetërore, "A.5.5." për institucionet akademike, "A.5.6." për kompanitë private, dhe "A.5.7." për burimet e tjera). Kur sinjalizuesi ose burimi jep material që nxirret, identiteti i tyre duhet të nxirret si burim në kontekst

<sup>108</sup> Dëshmitarë të mundshëm janë personat që ose janë intervistuar ose do të intervistohen nga palët. Për klasifikimin, "burimet e prokurorisë", shih ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-476 (OA2), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of z. Germain Katanga against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements"](#), 14 maj 2008, para. 1-2, 46, 49. Dëshmitarët e mundshëm dallojnë nga "palët e treta të pafajshme" (shih kategorinë B.3 më poshtë ndërsa të parët janë kontaktuar ose do të kontaktohen nga palët gjatë hetimeve përkatëse në kontekst të proceseve gjyqësore të DHS-së, palët e treta të pafajshme nuk kontaktohen në kontekst të hetimeve të palëve dhe mund të mos jenë të vetëdijshëm se emri i tyre është përmendur në kontekst të hetimeve të tilla. Ky dallim mund të jetë me rëndësi për palën marrëse dhe duhet të shënohet duke përdorur kode të ndryshme.



të asaj nxjerrjeje të informacionit, me kusht që të mos ketë probleme shtesë në lidhje me sigurinë dhe sinjalizuesi ose burimi nuk është i mbrojtur sipas nenit 35(2)(e) të Ligjit dhe rregullës 107 të Rregullores.

**Kategoria “A.6”:** Mjetet e përdorura për komunikim me dëshmitarët, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të komprometojë teknikat hetimore dhe vendndodhjen e dëshmitarëve. Në parim, ky informacion nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

**Kategoria “A.7”:** Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores, nëse nxjerrja e informacionit të redaktuar do të dëmtonte hetimet aktuale, ose të ardhshme.

(b) *Redaktimet sipas nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullave 80(4)(a)(i)-(ii) dhe 108(1)(b)-(c)*

*të Rregullores:*

**Kategoria “B.1”:** Të dhënat e kontaktit të dëshmitarëve, përfshirë numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat dhe postën elektronike (email), nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e personit në fjalë.

**Kategoria “B.2”:** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të anëtarëve të familjeve të dëshmitarëve, si numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat dhe posta elektronike, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e tyre. Individë të tillë janë jashtëzakonisht të rrezikuar duke pasur parasysh se ata nuk janë pajtuar që të jenë pjesë e proceseve të Dhomave të Specializuara dhe mund të mos jenë në dijeni se një anëtar i familjes është dëshmitar dhe, për këto arsye, ekziston rreziku se mund të konsiderohen sikur kanë lidhje me Dhomat e Specializuara. Redaktimet e të dhënave të kontaktit duhet të jenë në vijimësi. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese zbatohet vetëm për të mbrojtur dëshmitarin për të cilin redaktimet nuk janë më të justifikueshme, redaktimi nën këtë kategori duhet të hiqet kur të nxirret identiteti i dëshmitarit. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese nën këtë kategori zbatohet për sigurinë e një anëtari të familjes dhe identiteti i këtij anëtari të familjes nuk është i rëndësishëm për asnjë aspekt të njohur në këtë çështje, redaktimet e kësaj kategorie duhet të jenë në vijimësi. Për redaktimet që nuk hyjnë në rastet e lartpërmendura, pala që nxjerr informacionin duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

**Kategoria “B.3”:** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të individëve që janë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve, por të cilët nuk janë viktimë, dëshmitarë aktualë ose të mundshëm, burime ose anëtarët e familjeve të tyre (“palët e treta të pafajshme”),<sup>109</sup> përfshirë numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat, postën elektronike dhe fotografitë, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe

<sup>109</sup> Rregulla 80(1) e Rregullores. *Ngjashëm, 13 May 2008 Judgment*, para. 1, 40, 56.

mirëqenien e tyre. Individë të tillë nuk janë pajtuar të jenë pjesë e proceseve të Dhomave të Specializuara dhe mund të mos jenë në dijeni që emri i tyre përmendet në kontekst të këtyre proceseve dhe, për këtë arsye, janë në rrezik të shihen si dëshmitarë ose bashkëpunëtorë të mundshëm me Dhomat e Specializuara. Redaktimet e të dhënave të kontaktit nën këtë kategori duhet të jenë në vijimësi. Për individët që nuk janë relevant për asnjë nga problemet e njohura në këtë çështje, redaktimet e të dhënave identifikuese nën këtë kategori duhet të jenë në vijimësi. Përndryshe, pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

**Kategoria "B.4":** Vendndodhja e dëshmitarëve të pranuar në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dhënat e vendeve që përdoren për zhvendosjen e këtyre dëshmitarëve aktualisht dhe në të ardhmen, përfshirë ato që përdoren para hyrjes në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të komprometojë konfidencialitetin e këtyre vendeve, duke i rrezikuar kështu dëshmitarët e mbrojtur. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

**Kategoria "B.5":** Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(b)-(c) të Rregullores, nëse nxjerrja e informacionit të redaktuar do të shkaktonte rrezik të rëndë për sigurinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese ose anëtarëve të familjeve ose do të ishte në kundërshtim me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta për çfarëdo arsye.

*(c) Informacioni tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit në pajtim me*

*Rregulloren:*

**Kategoria "C":** Produkti i punës së brendshme që përmban cilido material që është objekt i nxjerrjes së informacionit në përputhje me rregullën 106 të Rregullores. Për redaktime të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit.

**Kategoria "D":** Komunikimet e bëra në kontekst të marrëdhënieve profesionale midis një personi dhe mbrojtësit të specializuar të tij në përputhje me rregullën 111(1) të Rregullores. Për redaktime të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit. Këto redaktime nuk mund të zbatohen për informacionin e 111(2)-(6) të Rregullores. Në këto raste, duhet t'i bëhet kërkesë panelit përkatës.

**Kategoria "F":** Redaktimet e autorizuara në procese të mëhershme sipas rregullës 81(1)(a) të Rregullores. Redaktime të tilla duhet të përmbajnë numrin e çështjes dhe të vendimit përkatës.

Redaktimet e kategorive A-D duhet të zbatohen, në përputhje me rregullat 106 dhe 108(1) të Rregullores, *mutatis mutandis*, për informacionin të barasvlershëm nga agjenci të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, përfshirë policinë

dhe prokurorinë e Kosovës, TPNJ-në, KFOR-in, UNMIK-un dhe EULEX-Kosova.<sup>110</sup> Kur përdoren redaktime të tilla, duhet të përfshihet shenja identifikuese e agjencisë në fjalë së bashku me kodin përkatës të redaktimit.

96. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje kundërshtimin e Mbrojtjes së z. Selimi dhe Mbrojtjes së z. Krasniqi<sup>111</sup> lidhur me përdorimin e redaktimeve standarde pa autorizim gjyqësor paraprak.<sup>112</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kategoritë e lartpërmendura të redaktimeve standarde zakonisht nuk kanë të bëjnë me informacion thelbësor për palën marrëse dhe standardi ligjor për përcaktimin nëse palës marrëse mund të mos i nxirret një informacion i tillë palës, është përkufizuar qartë.<sup>113</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu kujton se pala marrëse mund të kundërshtojë përshtatshmërinë e redaktimeve konkrete, duke krijuar kështu detyrim për palën nxjerrëse të informacionit që ta arsyetojë redaktimin,<sup>114</sup> dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake, me nismën e vet, mund të rishikojë përshtatshmërinë e redaktimeve standarde.<sup>115</sup> Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se sistemi i përcaktuar i redaktimit e përmirëson dhe e shton efikasitetin e procesit të nxjerrjes së informacionit duke respektuar në siç duhet të drejtat e të akuzuarve.

---

<sup>110</sup> Neni 37(1) i Ligjit.

<sup>111</sup> Parashtrimet me shkrim të Krasniqit, para. 13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, Mbrojtja e z. Krasniqi bëri të ditur se nuk kundërshton sistemin e redaktimit të miratuar në çështjen *Mustafa* (Transkript i datës 18 nëntor 2020, f. 156, rreshtat 18-19).

<sup>112</sup> Parashtrimet me shkrim të Selimit, para. 37-40, 42.

<sup>113</sup> *Shih më lart* para.85. *Shih gjithashtu*, Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në çështjen *Mustafa*, para. 76.

<sup>114</sup> *Shih më lart* para. 91.

<sup>115</sup> *Shih më lart* para. 93.

## 5. Redaktimet jostandarde

97. Redaktimet jostandarde kanë të bëjnë veçanërisht me emrat e dëshmitarëve identitetet e të cilëve nuk duhen t'i bëhen të njohura palës kundërshtare para fillimit të gjykimit dhe në rastet kur nuk duhet të nxirren pjesë të tëra të provave.<sup>116</sup> Në raste të tilla, pala që bën nxjerrjen e informacionit i paraqet paraprakisht në kohë të mjaftueshme kërkesë panelit përkatës për të mundësuar nxjerrjen në kohë të vendimit përkatës dhe më pas nxjerrjen e provave brenda afateve të parapara në Rregullore ose në vendimin e panelit. Në të njëjtën kohë, versioni i redaktuar i kërkesës duhet t'i jepet palës marrëse, e cila mund të përgjigjet në pajtim me rregullat 9 dhe 76 të Rregullores. Për më tepër, për t'i mundësuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të nxjerrë vendim objektiv, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") paraqet, brenda 10 ditësh pas njoftimit të kërkesës për mosnxjerrje të informacionit, vlerësim të rrezikut për secilin dëshmitar në lidhje me të cilën është kërkuar mosnxjerrja e identitetit. Për të shmangur nxjerrjen e informacionit të njëjtë disa herë dhe duke pasur parasysh sasinë e provave që pritet se do të nxirren në çështjen aktuale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se nuk është e nevojshme që pala që bën nxjerrjen e informacionit, të nxjerrë materialin përkatës në të njëjtën kohë me kërkesën për redaktime jostandarde. Me autorizim, të gjitha redaktimet jostandarde shënohen si **kategoria "E"**.

98. Redaktimet që hyjnë në këtë kategori hiqen pas urdhrit të panelit përkatës ose sapo arsyet për ligjëse nuk ekzistojnë më. Nëse njëra nga palët synon heqjen e një redaktimi jostandard që ka të bëjë me emrin e dëshmitarit sepse beson se arsyet që justifikojnë mosnxjerrjen e identitetit nuk ekzistojnë më, ajo palë e njofton Gjykatësin

---

<sup>116</sup> Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave në *çështjen Mustafa*, para. 88. *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-224, Pre-Trial Chamber II, [Decision on issues related to disclosure and exceptions thereto](#), 23 prill 2015, para. 7; [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 32; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 33.

e Procedurës Paraprake dhe ZMMD-në për këtë pesë ditë para heqjes së redaktimit në fjalë.

## V. VENDIM

99. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** palët dhe Administratoren që të zbatojnë parimet për nxjerrjen e provave e shtjelluara në paragrafët 46-54 të këtij vendimi;
- b. **URDHËRON** ZPS-në që të përfundojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(a) të Rregullores, së bashku me përmbledhjen e detajuar (në formën konfidenciale (të redaktuar) dhe publike (të redaktuar)), brenda **të premtes, 11 dhjetor 2020**;
- c. **URDHËRON** ZPS-në që të paraqesë kërkesat për masa mbrojtëse për materialin e rregullës 102(1)(b) të Rregullores brenda **të premtes, 8 janar**; të **premtës, 5 shkurt**; të **premtës, 5 mars**; të **premtës, 2 prill**, dhe të **premtës, 7 maj 2021**, dhe ta nxjerrë këtë material me redaktime, nëse miratohen, brenda dy javësh nga dita e vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me masat mbrojtëse.
- d. **URDHËRON** ZPS-në që të nxjerrë çdo material tjetër të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, që nuk ka nevojë për redaktime, në vijimësi;
- e. **URDHËRON** ZPS-në që të përfundojë nxjerrjen e të gjithë materialit të rregullës 102(1)(b) të Rregullores brenda **të hënës, 31 maj 2020**;
- f. **URDHËRON** ZPS-në që t'i japë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm të provave të rregullës 102(3) të Rregullores brenda **të premtes, 30 prill 2021**;
- g. **URDHËRON** Mbrojtjen që t'i bëjë me dije ZPS-së, brenda **të hënës, 14 qershor 2021**, ose në çdo kohë më herët, se në cilët prova të renditura në njoftimin e

- hollësishëm të përmendur në pikën (f) më lart, kërkojnë të kenë qasje me anë të nxjerrjes ose këqyrjes së informacionit;
- h. **URDHËRON** ZPS-në që, deri brenda të hënës, 5 korrik 2021, ose brenda tri javësh pasi Mbrojtja të ketë bërë të ditur sipas pikës (g) më lart, në cilëndo datë të mëhershme: (i) të nxjerrë ose t'i lejojë Mbrojtjes qasje në materialin e zgjedhur që nuk ka nevojë për redaktim; dhe (ii) të paraqesë kërkesë për masa mbrojtje, nëse ka, në lidhje me materialin e kërkuar nga Mbrojtja dhe të nxjerrë sa më parë që është e mundur një material të tillë me redaktime, nëse miratohet;
- i. **URDHËRON** ZPS-në që t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake brenda 10 ditësh pasi njoftimeve të Mbrojtjes, të përmendura në pikën (g) më lart, nëse e kundërshton rëndësinë materiale të provave;
- j. **URDHËRON** ZPS-në që të nxjerrë çdo material të rregullës 103 të Rregullores, objekt i kushteve të paragrafëve 67-68 të vendimit;
- k. **URDHËRON** ZPS-në që, nëse ndonjë material i rregullës 103 të Rregullores ka nevojë për redaktime, që të bëjë kërkesë për masa mbrojtëse sa më parë dhe të nxjerrë menjëherë një material të tillë me redaktime, nëse miratohet;
- l. **URDHËRON** ZPS-në që sa më shpejt ta njoftojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake për çfarëdo problemi në lidhje me materialin që ndikohet nga rregulla 107 e Rregullores;
- m. **URDHËRON** ZPS-në që të paraqesë propozim të përbashkët, pas konsultimeve me të gjitha ekipet e Mbrojtjes, në lidhje me formatin dhe kalendarin e tabelave për nxjerrjen e informacionit sipas rregullës 109(c) të Rregullores për qëllimet e çështjes aktuale brenda të premtes, 27 nëntor 2020.
- n. **URDHËRON** palët që të zbatojnë kriteret e sistemit të redaktimit të përcaktuara në paragrafët 82-98 të vendimit;

